



Prania / Datozuar Priljena/Prizdato Received/Usloveni	24-02-2023	3	Viti god Year
Organizata Organizacija Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shlop / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKQVSHUK	2040/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.44/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.44/2023 të datës 11.01.2023, të parashtruar nga ankuesi me përfaqësues juridik avokat

kundër organit të punësimit Bankës Qendrore të Kosovës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.44/2023 të datës 11.01.2023, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes postës së Kosovës me datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshill është protokolluar me datë 11.01.2023 me numër protokoll 170/2023, me pretendimin që të anulohet vendimi i Komisionit të Ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës me numër 7012/1 i datës 07.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokoll 170/2023 të datës 11.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizim i përgjithshëm nga përfaqësuesin e autorizuar i datës 05.01.2023; Shpallje e vendit të lirë të punës nga Banka Qendrore e Kosovës për pozitën "Udhëheqës të Divizionit të Mbikëqyrjes në vend i datës 26.09.2022; Njoftim përmes e-mailit nga Departamenti i Burimeve Njerëzore i datës 21.10.2022; Njoftim përmes e-mailit nga Departamenti i Burimeve Njerëzore i datës 08.11.2022; E-mail nga për Burimet.Njerezore@bqk-kos.org i datës 08.11.2022; Njoftim i datës 11.11.2022; E-mail nga Burimet.Njerezore@bqk-kos.org për i datës

11.11.2022; E-mail nga për Burimet.Njerezore@bqk-kos.org i datës 08.11.2022; E-mail nga Burimet.Njerezore@bqk-kos.org për i datës 14.12.2022; E-mail nga për Burimet.Njerezore@bqk-kos.org i datës 08.12.2022; E-mail nga Departamenti i Burimeve Njerëzore i datës 07.12.2022; E-mail nga Burimet.Njerezore@bqk-kos.org për i datës 02.12.2022; E-mail nga Burimet.Njerezore@bqk-kos.org për i datës 16.11.2022; E-mail nga për Burimet.Njerezore@bqk-kos.org i datës 08.11.2022; E-mail nga Departamenti i Burimeve Njerëzore i datës 08.11.2022; E-mail nga për Burimet.Njerezore@bqk-kos.org i datës 16.12.2022; Ankesë nga ankuesi për komisionin për shqyrtimin e ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës i datës 22.11.2022; Kërkesë nga për Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Njoftim nga Banka Qendrore e Kosovës i datës 15.11.2022; Komisioni i Ankesave Procesverbal i datës 05.12.2022; Vendim i Komisionit të Ankesave nga Banka Qendrore e Kosovës me numër protokolli 7012/1 i datës 07.12.2022; Pliko me numër R2672268 i datës 06.01.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar provat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent për vendosur** për ankesën A.nr. 44/2023 të datës 11.01.2023, të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur se Banka Qendrore e Kosovës ka publikuar konkursin e datës 26.09.2022 të publikuar për vendin e lirë të punës për pozitën *"Udhëheqës të Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend"*, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. Pas përfundimit të procedurave sipas njoftimit të datës 15.11.2022 nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Bankën Qendrore të Kosovës lidhur me rezultatet përfundimtare të kandidatëve, ankuesi me datë 22.11.2022 ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës. Ndërsa me datë 07.12.2022 Komisioni i Ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës ka nxjerr vendim me të cilin i ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar, me numër protokolli 7012/1, duke e udhëzuar ankuesin me mjetin juridik të ankesës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Ndaj të cilit vendim, ankuesi me datë 06.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postes së Kosovës me numër R2672268 përmes përfaqësuesit të autorizuar avokatit e pranuar në Këshill me datë 11.01.2023 dhe e protokolluar me numër 170/2023, me pretendime ankimore që të anulohet vendimi i Komisionit të Ankesave në Bankën Qendrore të Kosovës me numër 7012/1 të datës 07.12.2022 dhe të detyrohet Banka Qendrore e Kosovës, të rishpallë konkursin për pozitën *"Udhëheqës të Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me këtë çështje administrative ka konstatuar se marrëdhënia e punës në Bankën Qendrore të Kosovës, nuk rregullohet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarëve Publik, siç e përcakton nenin 2 paragrafi 2, sepse statusi i tij është i rregulluar me ligjin e veçantë, gjegjësisht sipas dispozitave të Ligjit të Punës, siç e përcakton neni 64 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe në ligjin e veçantë si në këtë rast, konkretisht në Ligjin Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në faktet e lartë cekuar, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pozita *"Udhëheqës të Divizionit të Mbikëqyrjes në Vend"*, e shpallur nga Banka Qendrore e Kosovës, nuk është pozitë e nëpunësve civil dhe mbi bazë të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, siç e përcakton dispozitave ligjore e nenit 24 paragrafin 3 Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.




Ankuesi siç shihet sipas Vendimit të datës 07.12.2022 ka bërë ankesë në Komisionin e Ankesave në kuadër të Bankës Qendrore të Kosovës, dhe sipas këshillës juridike është udhëzuar që të hap konfliktin administrativ në gjykatën kompetente, siç parashihet me nenin 74 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, mbi këtë bazë Kolegji e udhëzon ankuesin që ka të drejtë të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.44/2023

Çlirim ZEKA

Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit
- Guvernatorit në Bankën Qendrore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

